



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR DHËNIEN E LICENCËS, VEPRIMTARINË TREGTARE, OFERTËN PUBLIKE DHE KËRKESAT E RAPORTIMIT PËR SIPËRMARRJEN E INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE TË KRIJUAR NGA NJË SHOQËRI E HUAJ ADMINISTRUESE

Miraturar me Vendimin e Bordit nr. 68, datë 26.05.2011

Ndryshuar me Vendim Bordi nr. 68, datë 23.07.2015

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore përcakton dokumentacionin shtesë për dhënien e licencës për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese, si dhe kërkesat për veprimtarinë tregtare, ofertën publike dhe mënyrën e raportimit.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë të Nenit 39 të Ligjit nr. 10198 datë 10.12.2009, "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", (këtu e më poshtë "Ligji"). Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim dhënë atyre në Ligj.

Neni 3 Subjekti

Subjekt i kësaj rregulloreje është sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike e krijuar nga një shoqëri e huaj administruese, e licencuar në një shtet të Bashkimit Evropian ose në një shtet të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, e cila kërkon të tregtojë kuota dhe/ose aksione në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4 Dokumentacioni shtesë për licencim

1. Përveç dokumentacionit që kërkohet për t'u paraqitur sipas nenit 37 paragrafi 1 të Ligjit, dokumentet e mëposhtme duhet t'i bashkëngjiten aplikimit për marrjen e licencës për sipërmarrjen e huaj:

- a) kopje e noterizuar e licencës së shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhënë nga autoriteti përkatës në shtetin e Bashkimit Evropian ose në një shtet të lejuar nga AMF;
- b) statuti i shoqërisë administruese të sipërmarrjes së huaj;
- c) informacion në lidhje me strukturën organizative dhe funksionimin e shoqërisë administruese;
- ç) informacion në lidhje me aksionarët aktualë të shoqërisë administruese të sipërmarrjes së huaj;
- d) informacion mbi gjendjen e kapitalit të shoqërisë administruese të sipërmarrjes së huaj;
- dh) informacion për sipërmarrjet e administruara nga shoqëria administruese e huaj;
- e) informacion mbi depozitarin e emëruar nga shoqëria administruese e sipërmarrjes së huaj;
- ë) deklaratë e shoqërisë administruese të sipërmarrjes së huaj, që kjo e fundit:
 - i) nuk është në gjendje falimenti, paaftësie paguese;
 - ii) nuk është subjekt i ndonjë procedure për sekuestrimin e pasurisë së saj të luajtshme dhe të paluajtshme për shkak të detyrimeve thelbësore ndaj të tretëve (ente publike apo private);
 - iii) nuk është palë në procese administrative, gjyqësore, arbitrazhi e të ngjashme si këto, si rrjedhojë e të cilave pasuria e saj të jetë bllokuar për sigurimin e detyrimeve të pretenduara ndaj saj.
- f) dokumentin e shoqërisë administruese për caktimin e një agjenti përgjegjës në Shqipëri për ofrimin e kuotave/aksioneve të sipërmarrjes së huaj. Agjenti përgjegjës rregullon marrëdhëniet mes investitorëve vendas dhe shoqërisë së huaj administruese, i cili i jep investitorit vendas informacionin e duhur për sipërmarrjen e huaj të investimeve kolektive.
- * g) marrëveshjen për emërimin e një depozitari të licencuar në Shqipëri. Funksioni i këtij depozitari është lehtësimi i bërjes së pagesave nga investitorët dhe procedimi i shlyerjes së kuotave apo shpërndarja e dividendëve. Agjenti përgjegjës sipas pikës f) të këtij paragrafi, mund të jetë i njëjtë me depozitarin apo me kujdestarin e licencuar në Shqipëri.”

2. Dokumentet e mësipërme mund të jenë në gjuhën shqipe ose angleze.

Neni 5

Shqyrtimi i aplikimit

Autoriteti, brenda 2 muajve nga depozitimi i dokumentacionit të plotësuar sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore, shqyrton aplikimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese, për marrjen e licencës për tregtim kuotash/aksionesh në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe pasi bindet se:

- 1. investitorët vendas gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtje me atë që gëzojnë investitorët e vendit ku është krijuar sipërmarrja e huaj e investimeve kolektive,
- 2. sipërmarrja e investimeve nuk do të ketë pasoja në stabilitetin financiar të vendit,

jep miratimin për licencimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese për tregtim kuotash/aksionesh në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rast të kundërt, Autoriteti refuzon aplikimin.

Nëse brenda 2 muajve, nga depozitimi i dokumentacionit të plotë, Autoriteti nuk e ka refuzuar aplikimin, sipërmarrja e investimeve kolektive mund të fillojë veprimtarinë.

Neni 6

Marketingu dhe shitja e kuotave dhe/ose aksioneve

Vetëm pas marrjes së licencës, sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike e krijuar nga një shoqëri e huaj administruese, fillon marketingun dhe shitjen e kuotave dhe/ose aksioneve, nëpërmjet agjentit përgjegjës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Detyrimet në vazhdim

Të njëjtat detyrimet ligjore që aplikohen për sipërmarrjet vendase të investimeve kolektive, në lidhje me shitjen e kuotave dhe aksioneve, raportimet tek Autoriteti, publikimin e vlerës neto të asetëve, informimin e publikut për ndryshimet në prospektus dhe rregullat e fondit, aplikohen dhe për sipërmarrjen e huaj të investimeve kolektive.

Neni 8

Pagesa ndaj Autoritetit

(shfuqizuar)

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Elisabeta GJONI